



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:250705
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05707284

K.DH.SH.II.nr.163/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “VSH Lobby Bar Restaurant” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811385352 dhe seli në Prishtinë, Rr. “B”, Kompleksi Royal, C 15/14, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.843/23 të datës 15.11.2023, me datën 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.843/23 të datës 15.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.843/23 të datës 15.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “VSH Lobby Bar Restaurant” Sh.P.K., me numër unik

identifikues 811385352 dhe seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 166/23, i lejuar me datë 29.03.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që aktvendimin e ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datë 08.12.2023.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, mbi bazën e dokumentit përmbartimor, Urdhërësës për ndëshkim me gjobë mandatore për kundërvajtje nr. 002805, të datës 23.12.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 166/23, të datës 29.03.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të borxhit sipas urdhërësës për ndëshkim me gjobë mandatore për kundërvajtje të paguajë shumën prej EUR 200.00, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se sipas vendimit komunal për ndryshimin dhe plotësimet e rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave biznesore, përkatësisht nenit 8 është përcatuar orari i punës në periudha dimërore dhe verore, andaj meqenëse orari ka qenë nga ora 07:00 deri në ora 24:00, gjoba e shqiptuar në orën 23:20 është shqiptuar gabimisht. Për këtë arsye, i ka propozuar gjykatës që urdhrin përmbartimor ta anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit dhe ka tehskuar se të njëjtat nuk paraqesin bazë në kuptim të nenit 71 të LPP-së, për anulimin e urdhrit përmbarrimor. Me tej, ka shtuar se dokumenti përmbarrues i nxjerrë në procedurë administrative/kundërvajtje, në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së është bërë i përmbarrueshëm. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, dnërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.843/23 të datës 15.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “VSH Lobby Bar Restaurant” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811385352 dhe seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbarrimor P.nr. 166/23, i lejuar me datë 29.03.2023, nga Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj, është anuluar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se Urdhëresa për ndëshkim me gjobë mandatore për kundërvajtje nr. 002805, e datës 23.12.2022, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbarrimit, pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv dhe as dokument të besueshëm në kuptim të nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se “Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme kur ka pranuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrorit të përmbaremit privat, me të cilin është caktuar përmbaremi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se Urdhëresa për ndëshkim me gjobë mandatore për kundërvajtje nr. 002805, të datës 23.12.2022 nuk paraqet dokument përmbareme dhe nuk është i përshtatshëm për përmbaremi, për faktin se me nenin 21 përcaktohet se “*Organi përmbareme e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbareme(titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa me nenin 23 par. 2 të LPP-së, përcaktohet se: “*Vendimi i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër*”, e që në rastin konkret dokumentit përmbaremit i mungojnë elementet e aktit administrativ andaj i nëjti nuk paraqet dokument përmbaremit në kuptim të dispozitva të lartcekura.

Duke iu referuar edhe nenit 24 të LPP-së i cili parasheh se “*Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbaremit, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë*”, Gjykata vlerëson se dokumenti Urdhëresa për ndëshkim me gjobë mandatore për kundërvajtje nr. 002805, të datës 23.12.2022, nuk paraqet bazë për lejimin e përmbaremit pasi që në mungesë të klauzolës së përmbaremeshmërisë, nuk mund të vërtetohet se a është bërë i përmbaremeshëm sipas rregullave të procedurës me të cilën është nxjerrë.

Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e kreditorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbareme bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremit i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i

kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.163/24 me datë 20.05.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri